



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Raporti i monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve

Shqipëria 2021



HUBRinor

BALLKANI PERENDIMOR DHE TURQIA

Hulumtues

Era Sherifaj

Kontribues

Jonida Alite

Grafika dhe Faqosja

Maris Selamaj

Ky raport monitorimi u përgatit si pjesë e projektit Punësimi i të Rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti zbatohet nga Fondacioni Ana & Vlade Divac (Serbi), Organizata Prima (Mali i Zi), Aleanca Rinore (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Fondacioni i Komunitetit të Vullnetarëve (Turqi).

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Në brendësi të këtij raporti



**Hyrje – Rreth
projektit dhe
raportit të indeksit.**

Faqja 3



**Të dhëna nga
pjesëmarrja politike,
sociale dhe
ekonomike e të
rinjve.**

Faqja 5



**Krahasimi i të
dhënave përgjatë 6
viteve të
monitorimit.**

Faqja 11



**Rekomandime dhe
çështjet për
advokim.**

Faqja 14



**Shtojca 1-
Metodologjia e
studimit.**

Faqja 16

Hyrje – Rreth projektit dhe indeksit të pjesëmarrjes së të rinjve

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në kuadër të projektit “*Punësimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë*” i cili zbatohet në partneritet me fondacionin “Ana dhe Vlade Divac” në Serbi, “Aleancën Rinore” në Maqedoninë e Veriut, organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe “Fondacionin e Komunitetit të Vullnetarëve” në Turqi, prej vitit 2016, harton **“Raportin e Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të rinjve në Shqipëri”** duke kontribuar në zhvillimin e Raportit Rajonal që prezanton situatën e të rinjve në këto 5 vende.

Raporti i Monitorimit, shërben si një udhëzues për rekomandimet e politikave dhe iniciativa advokuese në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve. Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mundësive për të rinjtë, përmes lentes së 25 indikatorëve të pjesëmarrjes sociale, ekonomike dhe politike.

• **Dimensioni politik** i referohet mundësive të të rinjve për përfshirje në proceset politike, për t'u zgjedhur në poste politike, për t'u informuar për punën e qeverisë, parlamentit dhe bashkive, si dhe për të marrë pjesë në rrjete rinore.

• **Dimensioni ekonomik** i referohet shkallës së përfshirjes ose, të kundërtën, përjashtimit të të rinjve nga tregu i punës. Ky indikator mat shkallën e aktivitetit, të punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve.


• **Dimensioni social** i referohet pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën shoqërore. Ai vlerësohet në bazë të integritetit të të rinjve në komunitet nëpërmjet edukimit formal dhe joformal, apo mungesës së treguesve të përjashtimit të mundshëm të të rinjve nga jeta shoqërore – për shkak të varfërisë, sa të varur janë ata në sistemin e mirëqenies sociale apo kohës së kaluar në burg ose në institucionet e riedukimit.

Raporti është një mjet konkret që mund të përdoret nga institucionet shtetërore dhe OSHC-të për të identifikuar dhe trajtuar në mënyrë sistematike sfidat më urgjente të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në Shqipëri. Ai kontribuon në:

- Krahësimin e të dhënave sipas indikatorëve kryesorë të pjesëmarrjes së të rinjve: *politike, ekonomike dhe sociale*;
- Monitorimin e progresit të pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri ndër vite;
- Advokim për zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve.

Raporti për Shqipërinë për vitin 2021 ofron një analizë të të dhënave të mbledhura përmes hulumtimeve dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse siç janë: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Bashkive në vend.*

Të dhënat e këtij raporti janë pasqyruar gjithashtu në Raportin Rajonal për vitin 2021, të rrjetit “HUB-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, cili paraqet të dhëna krahasuese nga 5 shtetet (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, dhe Turqia)



“Në vitin 2021, përgjigjja
e institucioneve shqiptare
në lidhje me ofrimin e të
dhënave për
pjesëmarrjen e të rinjve
ishte më e lartë”

Të dhëna për Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministrat e rinj në qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2021 ¹
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	3.0%	3.0%	0.0%	2021 ¹
Deputetët e rinj në parlament	2.10%	1.4%	0.7%	2021 ¹
Kryebashkiakë të rinj	0.0%	0.0%	0.0%	2021 ¹
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	94.0%			2021 ¹
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	72.1%			2021 ¹
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar.	Po			2021 ²
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	43.0%			2021 ³

[1] Hulumtim

[2] Kërkesë për informacion drejtuar Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

[3] Kërkesë për Informacion nga 61 Bashkitë e Shqipërisë



“Në vitin 2021,
Shqipëria bëri një hap
përpara në ngritjen dhe
përmirësimin e
strukturave rinore në
nivel lokal dhe
kombëtar”

Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Të rinj në rrezik varfërie	Nuk ka të dhëna	-	-	2021 ⁴
Përqindja e të rinjve të varfër (të rinjtë që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	-	-	2021
Të rinj në burgje	36.9%	0.4%	36.5%	2021 ⁵
Të rinjtë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale	24.3%	-	-	2021 ⁶
Braktisja e shkollës së mesme	1.5%	0.9%	2.0%	2020-2021 ⁷
Të rinjtë e regjistruar në arsimin e lartë	21.7%	26.2%	17.2%	2021 ⁸
Të rinjtë e diplomuar në arsimin e lartë	26.0%	28.9%	21.6%	2021 ⁸
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	36.3%	52.7%	47.3%	2021 ⁹

[4] Partnerët Shqipëri dërguan një kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave, por ata u përgjigjën se këto të dhëna nuk janë publikuar ende për vitin 2021.

[5] Kërkesë për Informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

[6] Partnerët Shqipëri i dërgoi një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale


[7] Partnerët Shqipëri i dërgoi një kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

[8] Kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[9] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

“Në vitin e 6 të
monitorimit, të dhënat
për të rinjtë në Sistemin e
Mirëqenies Sociale
maten pjesërisht nga
institucionet përgjegjëse”


Here you can show
generic stats and metrics
for your email campaign.



Të dhëna për Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Norma e NEET (jo në edukim, punësim, trajnim)	26.1%	29.1%	23.2%	2021 ⁹
Shkalla e papunësisë të të rinjve	20.9%	21.4%	20.5%	2021 ⁹
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	11.6%	11.7%	11.6%	2021 ⁹
Shkalla e pjesëmarrjes si forcë punëtore të të rinjve	52.5%	46.3%	58.6%	2021 ⁹
Shkalla e punësimit të të rinjve	41.5%	36.4%	46.6%	2021 ⁹
Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	2.6%	2.5%	2.6%	2021 ¹⁰
Të rinjtë e vetëpunësuar	17.9%	13.9%	21.1%	2021 ⁹

[10] Request for Information to the Minister of State for Entrepreneurship Protection, Ministry of Finances, Ministry of Agriculture and Rural Development, and Ministry of Tourism and Environment.



“Ka një disbalancë gjinore në pjesëmarrjen ekonomike. Të rejat vazhdojnë të kenë një normë më të ulët të pjesëmarrjes në të gjithë treguesit e dimensionit ekonomik krahasuar me të rinjtë meshkuj”.

Krahasimet e të dhënave gjatë 6 viteve të monitorimit

Në përgjithësi, disa indikatorë kanë ndryshuar si pozitivisht dhe negativisht ndër vite, por krahasuar me të dhënat e prezantuara në raportin e parë, në vitin 2016, vërehet një përmirësim i dukshëm.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE

Të dhënat për **përfaqësimin e të rinjve në Parlament dhe pozicione të tjera politike** mbledhen përmes hulumtimit. Ky proces konsiston në hulumtimin e faqeve zyrtare të Qeverisë, Kuvendit dhe Bashkive, edhe pse në disa raste nuk gjenden informacionet e nevojshme – ose nuk ka informacion për moshën e personave të emëruar në pozicione politike, ose faqet e internetit nuk përditësohen rregullisht.

Për sa i përket të dhënave për **përdorimin e mjeteve online**, problem është identifikimi i kanaleve zyrtare të rrjeteve sociale të përdorura nga Qeveria, Parlamenti dhe Bashkitë. Në disa raste, komunikimi me qytetarët realizohet përmes kanaleve të rrjeteve sociale të Kryetarëve të Bashkive në vend të kanaleve zyrtare të Bashkive dhe në shumë raste kanalet zyrtare janë joaktive.

I vetmi tregues në dimensionin e pjesëmarrjes politike që nuk ka ndryshuar dhe nuk është përmirësuar ndër vite, edhe në vitin 2021 pas zgjedhjeve qendrore, është **përqindja e ministrave të rinj në qeveri** e cila vazhdon të mbetet 0.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se në qeverinë e re të vitit 2021, 80% e ministrave janë femra dhe moshë mesatare është 44 vjeç, me Ministren e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përkatësisht të moshës 32 dhe 31 vjeç, shumë afër me kufirin e moshës së të rinjve (15-29).

Ndërkohë, **përqindja e zëvendësministrave të rinj** është vetëm 3%, me një mesatare prej 1 (një) zëvendësministër të ri ndër vite. Numri i femrave të reja zëvendësministre në qeveri është më i lartë se i përfaqësuesve meshkuj. **Numri i deputetëve të rinj** mbetet shumë i ulët dhe viti 2021 shënon përqindjen më të ulët prej 2.1%, njësoj si në vitin 2016.

Gjithashtu, **përqindja e kryebashkiakëve të rinj** ka rënë në zero në tre vitet e fundit 2019-2021. Në vitin 2021 janë vetëm tre kryebashkiakë afër grupmoshës 33-35 vjeç. Faktor përcaktues në ndryshimin e kësaj përqindje janë zgjedhjet vendore që mbahen çdo 4 vjet, ndërsa zgjedhjet më të afërta vendore pritet të mbahen në vitin 2023.

94% e institucioneve qeveritare dhe Parlamentit dhe 72,1 % e bashkive **kanë krijuar mjete online për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje**. Pothuajse të gjitha institucionet kanë një faqe interneti dhe një llogari në Facebook, ndërsa Twitter nuk përdoret shpesh në Shqipëri. Ndër vite vihet re një rritje pozitive e pranisë së mjeteve online.

Miratimi i Ligjit Nr. 75/2019 “Për të rinjtë”, ka kontribuar në **krijimin e strukturave rinore në nivel kombëtar**, si “Agjencia Kombëtare e Rinisë”, “Këshilli Kombëtar Rinor”, dhe “Kongresi Rinor Kombëtar”.

Strukturat rinore në nivel vendor kanë arritur prezencën më të lartë në vitin 2019 me 57.4% por në dy vitet radhazi përqindja ka ardhur në rënie. Megjithatë, në zbatim të Ligjit Nr. 75/2019 “Për të rinjtë”, të gjitha bashkitë kanë për detyrë të krijojnë struktura rinore zyrtare lokale në formën e këshillave rinore vendore. Sipas informacionit të dhënë nga bashkitë, po punohet për krijimin e këshillave rinore vendore dhe deri në vitin 2022 shumica e bashkive do të kenë struktura rinore.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES EKONOMIKE

Në përgjithësi, për sa i përket të dhënave të pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve, shumica e treguesve kanë ndryshuar pak ose kanë mbetur të njëjtë.

Norma NEET në Shqipëri ka pasur një tendencë rënëse në përqindje të vogla ndër vite, duke arritur vlerën më të ulët në vitin 2021 me 26.1%. Me kalimin e viteve, numri i femrave në NEET ka qenë më i lartë se numri i meshkujve në NEET.

Papunësia tek të rinjtë në vitin 2021 është në të njëjtën përqindje (20.9%) si në vitin 2020. Shkalla e papunësisë tek të rejtat femra është pak më e lartë se shkalla e të rinjve meshkuj të papunë.

Papunësia afatgjatë ka një rritje të lehtë në 2021 me 0.2%, por përqindja (11.6%) është ende më e ulët se përqindja në 2016, 2017 dhe 2018. Papunësia afatgjatë për femrat për herë të parë në 2021 është më e lartë sesa për meshkujt. Nga viti 2020 deri në vitin 2021 papunësia afatgjatë e femrave u rrit me 1.5% dhe u ul me 1% për meshkujt.

Shkalla e punësimit e të rinjve dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të të rinjve janë rritur përkatësisht me 9.1% dhe 6.8% në krahasim me 6 vite më parë.

Treguesi që ka shënuar vlerën më të ulët ndër vite (2.6%) janë **të rinj që kanë nisur bizneset e tyre me mbështetjen financiare të shtetit**. Ky tregues llogaritet duke marrë në konsideratë përfituesit e skemave mbështetëse financiare të ofruara nga qeveria. Përlllogaritja e këtij treguesi vijon të jetë e pjesshme pasi shumica e të dhënave mungojnë dhe nuk maten nga institucionet.

Numri i të rinjve të vetëpunësuar ka ndryshuar në mënyrë drastike ndër vite, duke shënuar normën më të lartë në vitin 2016 (29%), normën më të ulët në vitin 2018 (0.9%) dhe në vitin 2021 Shqipëria qëndron në 17.9%.

Të rinjtë meshkuj vazhdojnë të kenë një përfshirje më të mirë se sa të rejtat në shkallën e punësimit të të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve në fuqinë punëtore dhe shkallën e vetëpunësimit, dhe një përqindje më të ulët në NEET dhe shkallën e papunësisë së të rinjve.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES SOCIALE

Nuk ka të dhëna ndër vite për shumicën e treguesve në Dimensionin e Pjesëmarrjes Sociale, veçanërisht për përqindjen e **të rinjve të varfër dhe të rinjve pjesë e sistemit të mirëqenies sociale**.

Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT), që prej vitit 2017 mat çdo vit treguesin “njerëz në rrezik nga varfëria” sipas grupmoshave dhe gjinisë. Shkalla e të rinjve në rrezik të varfërisë varion ndërmjet 24% - 28% ndër vite, me vlerën më të ulët në vitin 2020 në 24.4% dhe vlerën më të lartë për femrat e reja në rrezik të varfërisë me 28.1% në 2019.

Të dhënat për përqindjen e njerëzve të varfërve nuk janë matur dhe siguruar nga INSTAT dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë viteve 2017-2021. Llogaritja e këtij treguesi është e vështirë, pasi Shqipëria nuk ka një “minimum jetik” të rregulluar me ligj, duke e bërë shumë subjektive matjen dhe mbledhjen e të dhënave.

Në vitin 2021 për herë të parë në gjashtë vitet e raportit të monitorimit, Shqipëria ka disa të dhëna për **të rinjtë në sistemin e mirëqenies sociale**. Të rinjtë përbëjnë 24.3% të përfituesve të mbështetjes nga sistemi i mbrojtjes sociale janë të rinj. Në Shqipëri ekzistojnë tre programe të ndihmës sociale: skema e ndihmës ekonomike, skema e ndihmës së aftësisë së kufizuar dhe skema e kujdesit për shërbimet sociale. 24,3% e përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike janë të rinj; të dhënat për dy skemat e tjera vijnë të jenë të pjesshme dhe të ofruara për grupmosha të ndryshme dhe jo specifikisht 15-29 vjeç.

Përqindja e të rinjve në burgje është rritur me 6.9% krahasuar me vitin e kaluar dhe shumica e të burgosurve (36.5%) janë të rinj meshkuj.

Treguesit e arsimit tregojnë përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e parë të raportit të monitorimit, veçanërisht **braktisja e arsimit të mesëm**, i cili është i vetmi tregues që ka shënuar rënie gjatë gjithë viteve, me vlerën më të ulët prej 1.5%, në vitin 2021. Duhet theksuar se për Shqipërinë ky tregues do të quhej më mirë “lënia e arsimit të mesëm” pasi arsimi i mesëm në Shqipëri nuk është i detyrueshëm dhe nuk mund të quhet braktisje. Shkalla e braktisjes së arsimit të mesëm është më e lartë në zonat rurale (3.3%) dhe shumica e nxënësve të cilët braktisin janë të rinj meshkuj me 2%.

Përqindja e të rinjve (18-29) të regjistruar në arsimin e lartë është 21.7%. Ndërkohë, përqindja e të rinjve që kanë mbaruar arsimin e lartë, pas një rënie të vogël në vitin 2020, është rikthyer në nivelin mesatar ndër vite, në 26% në 2021.

Përqindja e të rejave femra (28.9%) që përfundojnë me sukses nivelin e tyre akademik është më e lartë se e të rinjve meshkuj (21.6%). Në krahasim me të rinjtë, të rejat janë më të përkushtuara ndaj arsimit dhe kanë një përqindje më të ulët të braktisjes së arsimit të mesëm, një gatishmëri më të lartë për t'u regjistruar në arsimin e lartë dhe një raport më të lartë të diplomimit në arsimin e lartë.

Ndërkohë, **shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal** (4 javët e fundit të 2021) është 36.3%.

Rekomandime dhe çështje për advokim

Ky sesion ofron një seri rekomandimesh për çdo dimension, të cilat duhet të adresohen nga institucionet dhe aktorët që punojnë në fushat përkatëse. Në të gjashtin vit radhazi të monitorimit, mbetet ende problem mungesa e të dhënave statistikore për pjesëmarrjen sociale të të rinjve.

REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN POLITIKE TË TË RINJVE

Të rinjtë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozicione politike, si kryetar bashkie, zëvendësministër apo ministër në Shqipëri. Situata e përfaqësimit të tyre në jetën politike nuk është përmirësuar ndër vite. Edhe pse zgjedhjet qendrore të vitit 2021 në Shqipëri ishin një moment për t'u përdorur nga partitë politike për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve duke promovuar deputetë të rinj, ministra të rinj dhe zëvendësministra të rinj, nuk pati shumë ndryshime.

Disa rekomandime që duhet të merren parasysh në këtë kontekst deri në zgjedhjet e ardhshme qendrore janë si më poshtë:

- **Qeveritë, parlamentet, partitë politike dhe organizatat rinore duhet të zhvillojnë strategji/programe për të rritur numrin e të rinjve në poste politike.**

Është e nevojshme t'i kushtohet një vëmendje e veçantë ndërgjegjësimit, informimit dhe inkurajimit të të rinjve për pjesëmarrje në postet politike. Pjesëmarrja e të rinjve gjithashtu mund të përmirësohet përmes programeve të edukimit dhe ngritjes së kapaciteteve, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të të rinjve për tu përfshirë në politikë.

Përqindja e kryebashkiakëve të rinj ka qenë jashtëzakonisht e ulët ndër vite dhe 0% në tre vitet e fundit. Zgjedhjet e ardhshme vendore priten në vitin 2023 dhe janë një mundësi e mirë për të promovuar dhe zgjedhur më shumë të rinj dhe të reja, në këto poste.

- **Strukturat rinore (si: këshillat/parlamentet/sindikatat) që sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes, duhet të krijohen dhe/ose të fuqizohen.**

Procesi i krijimit të strukturave rinore në nivel vendor është në rrugë të mbarë, pasi disa nga bashkitë kanë krijuar Këshillat Rinore Vendore, dhe disa të tjera janë në proces të krijimit të tyre. Megjithatë, është e nevojshme të unifikohet struktura dhe funksionimi i tyre. Për këtë qëllim, zhvillimi i një udhëzuesi praktik do të kontribuonte në ngritjen e strukturave të duhura në nivel vendor.

- **Institucionet publike duhet të përmirësojnë përdorimin e mjeteve online për të përmirësuar komunikimin me të rinjtë.**

Ka një rritje të mjeteve online që përdoren për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje si në nivel vendor ashtu edhe në atë kombëtar. Megjithatë, disa nga faqet web të institucioneve publike nuk mund të aksesohen, e në disa të tjera mungon informacioni i nevojshëm që duhet të ofrojnë, ose informacioni është i vjetëruar. Përditësimi i mjeteve online dhe ofrimi i informacionit për publikun mbetet një domosdoshmëri. Në këtë kontekst, ministritë dhe bashkitë duhet të përditësojnë faqet e tyre të internetit dhe mediat sociale, të ndajnë më shumë informacion me qytetarët e tyre dhe t'u ofrojnë atyre mundësinë e angazhimit në procese pjesëmarrëse.

REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN EKONOMIKE TË TË RINJVE

Të rinjtë janë agjentë kryesorë që mund të ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit, por situata në lidhje me treguesit e pozicionit të tyre në tregun e punës nuk ka ndryshuar ndjeshëm.

Norma NEET në Shqipëri vazhdon të jetë në një nivel të konsiderueshëm mbi 25%. Për të ulur këtë nivel të lartë të normës NEET, institucionet përgjegjëse duhet të luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm në identifikimin e të rinjve NEET, por në zhvillimin e mekanizmave konkretë të angazhimit të të rinjve në arsim, trajnim dhe punësim. Për të përshtatur kërkesën dhe ofertën në tregun e punës dhe për të harmonizuar interesat e studentëve me nevojat e tregut, është e nevojshëm ngritja e shërbimit të këshillimit të karrierës, një shërbim i munguar në nivel kombëtar, i cili do të kontribuonte në orientimin dhe punësimin e të rinjve.

Të dhënat për sipërmarrjen e të rinjve tregojnë se një numër i vogël i të rinjve zgjedhin vetëpunësimin si opsion dhe ata që e zgjedhin atë mund të mos kenë mbështetjen e duhur.

Të rinjtë sipërmarrës, veçanërisht gratë e reja, duhen stimuluar dhe promovuar, duke ofruar informacion, asistencë dhe mbështetje financiare.

Gjatë vitit 2021, vetëm 2.6% e të rinjve në Shqipëri nisën bizneset e tyre me mbështetjen financiare të shtetit. Qeveria po punon për krijimin e *Tekno Parkut të parë në Shqipëri*, i cili do të lejojë të gjithë bizneset e vogla dhe të mesme të punojnë në një ambient të përbashkët. Të rinjtë e interesuar për ngritjen e stat-upeve të tyre dhe modeleve të sipërmarrjes, kane ende nevojë për inkubatorë dhe akseleratorë profesional, të cilët mund t'ju ofrojnë akses në fonde, programe trajnimi dhe mentorimi, mundësi rrjetëzimi, ekspozim ndaj tregjeve ndërkombëtare etj.

REKOMANDIME PËR PJESËMARRJEN SOCIALE TË TË RINJVE

Pjesëmarrja e të rinjve në arsimin dhe trajnimin joformal duhet të inkurajohet.

Të rinjtë duhet të fitojnë njohuri dhe aftësi, të cilat më vonë mund të përdoren në tregun e punës. Institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor duhet të zhvillojnë programe specifike për integrimin e të rinjve nga grupet e marginalizuara në sistemin arsimor. Gjithashtu, zhvillimi i Shërbimit të Këshillimit të Karrierës në nivel vendor, i cili është në fazat fillestare në Shqipëri, do t'u mundësojë të rinjve të përshtatin vendimet dhe veprimet e tyre në rrugët e karrierës. Përveç institucioneve, familja dhe bashkëmoshatarët janë të rëndësishëm për mësimin joformal. Në këtë pikë, të rinjtë mund të rrisin kompetencat sociale, për rrjedhojë përfshirja e tyre sociale do të përmirësohet.

Një shkallë më e ulët e pjesëmarrjes sociale ul mundësinë e edukimit joformal. Në situatën e varfërisë afatgjatë, shfaqet edhe privimi social. Veçanërisht të rinjtë me status më të ulët socio-ekonomik kanë një përqindje më të ulët pjesëmarrjeje. Varfëria mund të çojë në një mundësi më të ulët pjesëmarrjeje sociale dhe edukimi joformal. Është thelbësore që institucionet përgjegjëse të identifikojnë të rinjtë në rrezik të varfërisë dhe të rinjtë e varfër dhe t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë situatën e tyre për të parandaluar emigrimin e tyre.

Përcaktimi i një “minimumi jetik” në Shqipëri dhe nismat ligjore për miratimin e tij, përfshirë procesin e konsultimit publik lidhur me të, janë një hap i rëndësishëm që do të lehtësojë edhe procesin e mbledhjes së të dhënave në këtë drejtim. Siç shihet nga raporti, të dhënat mbi “sistemin e mirëqenies sociale” janë kryesisht të pjesshme, ndaj nevojitet një mbledhje e saktë e të dhënave, duke përfshirë dhe specifikuar të dhënat për grupmoshën 15-29 vjeç që është pjesë e sistemit të mirëqenies sociale.

Shtojca 1:

Shënime metodologjike

Që nga viti 2016, u përzgjedh një grup indikatorësh, bazuar në një proces analitik të përbërë nga hulumtime të thelluara në zyrë si dhe konsultime me ekspertë. Në tabelën e mëposhtme janë renditur të gjithë indikatorët, mënyra e llogaritjes si dhe burimet e të dhënave.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Të dhëna	Femër	Mashkull	
Ministrat e rinj në qeveri	Numri i ministrave të rinj (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministreve të reja femra (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i ministrave	Hulumtim
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	Numri i zëvendësministrave të rinj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i femrave të reja zëvendësministre (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i zëvendësministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Hulumtim
Deputetët e rinj në parlament	Numri i deputetëve të rinj (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputeteve të reja femra (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputetëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i deputetëve	Hulumtim
Kryebashkiakë të rinj	Numri i kryetarëve të rinj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetareve bashkiake të reja femra (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetarëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Hulumtim
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	Mesatarja e (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Twitter / Numri total i institucioneve publike në nivel qendror + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Facebook / numri total i institucioneve publike në nivel qendror) + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë një faqe internet / Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në nivel qendror)	N/A	N/A	Hulumtim

Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	Mesatarja e (Numri i bashkive që kanë Twitter / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë Facebook / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë një faqe internet / Numri total i bashkive)	N/A	N/A	Hulumtim
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar	Numri i strukturave rinore në nivel kombëtar	N/A	N/A	Informacioni i dhënë nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve dhe hulumtimi në zyrë
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	Numri i bashkive që kanë strukturë rinore (këshilla, parlamente, sindikata) / Numri total i bashkive.	N/A	N/A	Informacioni i dhënë nga Bashkitë dhe Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Të dhëna	Femër	Mashkull	
Norma e NEET	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e punësimit të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	Numri i të rinjve (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i njerëzve që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Numri i femrave të reja (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i femrave që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë) / Numri total i meshkujve që kanë marrë mbështetje financiare nga qeveria (ministritë)	Informacioni i dhënë nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Të rinjtë e vetëpunësuar	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
	Data	Female	Male	
Të rinj në rrezik varfërie	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Përqindja e të rinjve të varfër (të rinj që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	N/A
Të rinj në burgje	Numri i të rinjve (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i femrave të reja (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Të rinj pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale	Të rinj (15-29) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike / Totali personave përfitues të skemës së ndihmës ekonomike	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Informacioni i dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Të rinj të regjistruar në arsimin e lartë	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Të dhënat e llogaritura dhe të siguruara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit	Informacioni i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit
Braktisja e shkollës së mesme	Të rinj (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë / Të rinj gjithsej (18-29)	Të rejat femra 18-29 vjeç të regjistruara në Arsimin e Lartë / Numri total i të rejave femra (18-29)	Të rinj meshkuj 18-29 vjeç të regjistruar në Arsimin e Lartë / Numri total i të rinjve meshkuj (18-29)	Informacioni i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinj të diplomuar në arsimin e lartë	Të rinj (18-29) të diplomuar në 2021 / Të rinj (18-29) të regjistruar në 2021	Të rejat femra (18-29) të diplomuar në 2021 / Të rejat femra (18-29) të regjistruar në 2021	Të rinj meshkuj (18-29) të diplomuar në 2021 / Të rinj meshkuj (18-29) të regjistruar në 2021	Informacioni i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruara nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)

www.partnersalbania.org

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,
kati 10, ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri

Partnerët Shqipëri
për Ndryshim dhe Zhvillim

Projekti WB&T for EmploYouth po zbatohet nga:

